



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0616

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), si dhe nenit 21 dhe 29 të Rregullores së Punës së OSHP 01/2020 e amendamentuar me 09. 08. 2023, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Arhiko .Ing” SH.P.K., N.N.SH. "Vizion Project", “Arch Empire” L.L.C., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë, Vendimin për dhënie të një kontrate të Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime” me numër të prokurimit 206-23-5282-2-2-3, me 13.10.2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Arhiko .Ing” SH.P.K. me nr. 2023/0616, e datës 25/08/2023, dhe ankesa e OE “N.N.SH Vizion Project”- Prishtinë me nr. 2023/0621 e datës 25/08/2023, kurse vendimi i AK Ministria e Shëndetësisë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për ndërtimin e QKMF Shtime” me numër të prokurimit 206-23-5282-2-2-3 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. **Refuzohet** si e pabazuar ankesa e OE “Arch Empire L.L.C” me nr. 2023/0622, e datës 25/08/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit të sipërcituar.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues “Arhiko .Ing” Sh.P.K., N.N.Sh. "Vizion Project" që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

4. Konfiskohen mjetet e deponuara për ankesën e OE “Arch Empire L.L.C” konform nenit 36 par 5 i Rregullores së Punës së OSHP-se.

A r s v e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 24.05.2023 ka paraqitur Njoftimin për kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për ndërtimin e QKMF Shtime” me numër të prokurimit 206-23-5282-2-2-3.

Me 02.08.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi rezultatet e konkursit të projektimit të Autoritetit Kontraktues.

Me 07.08.2023, OE “Arhiko.Ing Sh.P.K ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 15.08.2023 AK, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues si të pabazuar.

Me 07.08.2023, OE “Arhiko.Ing Sh.P.K ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 15.08.2023 AK, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues si të pabazuar.

Poashtu, në të njëjtën ditë me 07.08.2023, kërkesa për rishqyrtim kanë paraqitur edhe OE N.N.SH “Vizion Project” dhe OE “Arch Empire L.L.C” të cilat me datë 15.08.2023 AK i ka refuzuar.

Operatori ekonomik “Arhiko.Ing Sh.P.K i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me 25/08/2023 ka paraqitur ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokollit 616/23.

Me datën 25. 08. 2023, si palë e pakënaqur ka paraqitur ankesë N.N.Sh. "Vizion Project" e cila është regjistruar me numër protokollit 621/23.

Me datën 25. 08. 2023, si palë e pakënaqur ka paraqitur ankesë edhe “Arch Empire L.L.C” e cila është regjistruar me numër protokollit 622/23.

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të paraqtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të

mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 19.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

Për ankesën 616/23, OE "Arhiko. Ing"

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar,
- Të rivlerësohet aktiviteti i prokurimit

Për ankesën 621/23, OE N.N.Sh. "Vizion Project"

- Ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim

Për ankesën 622/23, OE "Arch Empire L.L.C"

- Ankesa të refuzohet si e pabazuar;
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK-së përkitazi me këtë ankesë

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit, ndërkaq është pajtuar që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, ndërsa Operatori Ekonomik "Arhiko. ING" ka deklaruar se pajtohet, OE N.N.Sh. "Vizion Project" ka deklaruar se pajtohet dhe OE "Arch Empire L.L.C" nuk është deklaruar.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues për ankesën Psh.nr. 616/23

Konstatimi i parë (I)- Eksperti teknik sqaron se në përgjithësi pretendimet e palës ankuese: Arhiko.ing SHPK janë të marra nga Raporti Vlerësues i Komisionit profesional nga AK. Ku për poentim janë të listuar këto komente e nga ana e ankuesit janë përdorur me modifikime të vogla si argumente.

Nëse merret një paralele mes raportit të jurisë dhe pretendimet e palës ankuese, është shumë e qartë që nga ana e OE janë bërë modifikime të vogla, ku në raste të caktuara e ka orientuar komentimin në kontekst krejt tjetër profesional, duke shkaktuar konfuzion në kuptim të mirfilltë.

Pretendimi i ankuesit se është vlerësuar padrejtësisht dhe i ranguar ulët janë shumë subjektive se nëse analizohen komentet e Jurisë profesionale për Projektin si bazë është: *Nuk është mbështetur as në të dhënat elementare të parashtruara karshi detyrës projektuese*. Tutje vijojnë komentet tjera të cilat sipas mendimit tim profesional tregojnë një nivel të ulët teknik të prezantimit të projektit. Disa nga pretendimet si fakte janë të qëndrueshme, sepse janë vlerësuar prej një ekipe profesionale, ndërsa si argumente nuk ka origjinalitet dhe as analizë të mirfilltë profesionale.

Në vendimin e AK me nr 422-VII-2023, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik për formimin e komisionit për vlerësim, është e qartë titulli përkatës për secilin anëtar të komisionit vlerësues, e që vërteton profesionin dhe titullin që e zotërojnë secili. Andaj ekspertit teknik vlerëson se pretendimi i OE ankuese është i pabazuar.

Konstatimi i dytë (II)- Eksperti teknik sqaron se në pretendimin e ngritur nga OE ankues për propozimin me Shifër 8485 janë të pabazuara sepse ka mungesë të argumenteve. Analizuar propozimin përkatës me shifrën 8485, pretendimet nuk qëndrojnë sepse janë evidente dhe të trajtuara nga shumica e rasteve. Argumenti ku ankuesi cilëson që ashensori nuk ka qasje në etazhin e përdhësës, duhet të ishte më i qartë në argumente sepse në këtë etazhë figurojnë dy ashensor dhe çasja është e mirfillt. Në kuadër të grupacionit të ordinancave ekziston hapësira e tualeteve (nyjet sanitare), që poashtu si argument nuk qëndron. Pretendimi tjetër i ankuesit në lidhje me pozitën ku janë laboratorët që nuk është paraparë hapësira për mirëmbajtje, por ekziston mundësia e revidimit ku një hapësirë mund të koncertohet në atë të mirëmbajtjes. Argumenti rreth mungesës së tualeteve në kuadër të hapësirës për edukim është i paqëndrueshëm bazuar në kërkesën e detyrës projektuese dhe zgjedhjes arkitektonike të bërë nga OE 8485. Edhe sa i përket bodrumit, argumenti është i paqëndrueshëm sepse varësisht nga konfigurimi i terrenit ajo mund të jetë Bodrum ose Suteran e ku OE me shifër 8485 e ka të prezantuar si suteran. Andaj nga kjo çfarë u sqarua më lartë vlerësoj se ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

Konstatimi i tretë (III)- Eksperti sqaron se sa i përket pretendimit se njëri nga OE ofertues ka përdorur edhe disa shkronja në vend të numrave nuk përbënë ndonjë problem i cili mund të ndikoj në vlerësim. E rëndësishme është të mos ofertohej me emër në mënyrë që të dihet saktësisht se projekti i kujt është. Andaj përdorimi i numrave apo shkronjave në shifër nuk përbënë ndonjë ndikim negativ në proces të vlerësimit.

Sa i përket pretendimeve të tjera, si grupacion në kuadër të përdhësës shifet që është trajtuar pjesa e ordinancave dhe ky fakt nuk duhet të jetë i qëndrueshëm. Nuk është caktuar si është bërë matja e jo përshtatshmërisë (sa duhej të ishte dimensionimi i minimumi i strehës). Sipas detyrës projektuese kjo hapësirë për mirëmbajtje nuk është prezantuar por mund të revidohet në fazën e projektit zbatues sepse është hapësirë dhe jo kthinë.

Pretendimi se mungon paradhoma te shërbimet e diagnostikës nuk qëndron sepse në bazën e suteranit në këtë grupacion figuron kjo hapësirë me sipërfaqe 16.29 m², nëse është fjala për hapësirë mirëmbajtje në po këtë pozicion edhe ky pretendim është plotësisht i paqëndrueshëm sepse ekziston si hapësirë. Distanca e depos për Rekuizita është zgjidhje e projektantit dhe nuk paraqet ndonjë problem funksional andaj nuk mund të merret për bazë ky pretendim. Në kuadër të depos për materiale të ndryshme në bazën e Suteranit është e paraparë edhe hapësira për IT dhe mund të modifikohet sipas nevojës së pajisjeve dhe as ky pretendim nuk qëndron. Tek grupacioni i mirëmbajtjes ku potencohet që ka mungesë banjo si argument qëndron edhe pse konsideroj që kjo duhej të ishte vetëm toalet por gjithsesi toaleti mund të ndryshohet në banjo në projektin kryesor, andaj edhe ky pretendim njëjtë nuk duhet të merret parasysh. Mungesa e Gardërobës dhe Dushit është evidente dhe ky pretendim është i qëndrueshëm. Në përgjithësi pretendimet janë të pa argumentuara teknikisht, komentet të cilat kanë argumente të njëjtat mund të revidohen pa cenuar zgjidhjen funksionale dhe arkitektonike të projektit.

Sipas ekspertit teknik këto pretendime të ngritura janë të pabazuara, në shumicën e rasteve janë bërë konkluzë - komente duke mos ofruar standarde matëse. Ka pretendime të cilat nuk duhet qëndruar sepse mund të revidohen në fazën e projektit kryesor duke mos penguar apo ndryshuar konceptin e projektit. Si argumente të qëndrueshme duhet konsideruar disa hapësira të patrajtuara të cilat lehtësisht mund të ipen si vërejtje dhe të njëjta mund të inkorporohen në kuadër të grupacionit përkatës.

Konstatimi i katërt (IV)- Sipas ekspertit teknik këto pretendime të ngritura janë shumë të paqarta dhe te paargumentuara. OE jep analizë dhe komente për hapësirat të cilat nuk figurojnë fare në Propozimin me Shifrën 0306 andaj nuk duhet të merren si të bazuara. Tek hapësira për edukim dhe promovim shëndetësor ekziston grupacioni i nyjeve sanitare në kuadër të të cilës është edhe toaleti për hendikep andaj ky pretendim është i paqëndrueshëm. Argumenti rreth pozicionimit të hapësirës për persona të pajetë mendoj që duhet të vlerësohet nga ana e jurisë profesionale e jo të merret si argument pa asnjë bazë teknike krahasuese. Edhe pse pas analizës së projektit një kthinë e tillë nuk figuron në asnjërën prej etazheve. Ky pretendim duhet cilësuar si i pabazë.

Konstatimi i pestë (V)- Pozicioni i ashensorëve është i përshtatshëm sepse ka kontroll nga recepcioni, çasje direkte nga hyrja etj. Ky pretendim nuk qëndron. Sipërfaqja e dhomës së infuzioneve është në pajtueshmëri të plotë me kërkesën, ndërkaq paraqitja teknike e dy ose tre shtretërve është komplet jorelevante. Argumenti se ka prezantim të pisuarëve në toalete nuk qëndron. Dhoma e infermiereve ka lidhje me hollin-koridorin përmes derës pra është e pabazë. Sporetli nuk konsiderohet si element ndërtimi dhe statik dhe në këto raste duke marr parasysh hapësirën e mjaftueshme mund të pozicionohet kudo në kuadër të barnatores. Organizimi jo i përshtatshëm tek shërbimet e diagnoztikes, nuk ka argument. Pretendimet e palës ankuese janë pothuajse te gjitha të pa baza dhe të paqëndrueshme. Duke marr parasysh nivelin e projektit Koncept-Ideor ku gjatë procesit ka hapësirë për revidim e sidomos kur ka të bëjë me pozicione të enterierit, andaj edhe ky pretendim konsiderohet i pabazuar.

Konstatimi i gjashtë (VI)-Eksperti sqaron se në pretendimin e ngritur OE ankues pretendimet i ka të bazuara në komentet e jurisë profesionale. Tutje konsideron që shumica e komenteve janë të revidueshme pasi që shumë prej tyre kanë të bëjnë me elemente lëvizëse të enterierit e jo statike të objektit të cilat mund të përmirësohen në fazën e projektit zbatues. Ndërkaq argumentet të cilat janë të bazuara janë evidentuar dhe poentuar karshi metodës së poentimit të dhënë në Dosjen e Tenderit Aneksi 1, Par. IV.

Pretendimi që nuk ka pisuar për personel te ordinacat nuk qëndron sepse në kuader të ordinancave ka dy grupe të nyjeve sanitare dhe në njëërën është e vendosur pisuara ne toaletin e meshkujve. Sporteli tek hapësira e punës për administrim të laboratorit nuk figuron por teknikisht është çështje enterieri dhe ka mundësi të revidohet. Sipas kërkesës është e paraparë të jetë kuzhina e çajit, prape është çështje enterieri bazuar në hapësirë mund të revidohet dhe një pjesë mund të vendoset kuzhina e çajit. Te pjesa e Rentgenit mungon hapësira e paradhomës dhe qëndron si argument. Pretendimi që lidhja në mes të dhomës së mjekut me ordinancë qëndron, mirëpo teknikisht ky element mund të revidohet në fazën e projektit kryesor përmes një hapje/dere.

Dhoma për trajner është në përputhje me kërkesën në aspektin e sipërfaqes, mungesa e dritareve është zgjedhje e projektuesit dhe si e tillë duhet të vlerësohet nga ekipa profesionale, është vetëm koment dhe nuk mund të përfilllet. Dyert e ashensorit edhe pse nuk kanë informatë/dimensione në dukje grafike dhe bazuar në aspektin teknik duken të jenë të vogla dhe një fakt i tillë në shërbimet shëndetësore çdo herë mund të jetë problem. Në përgjithësi disa devijime të vogla teknikisht mund edhe të revidohen në fazën tjetër projektuese andaj nuk ka argumente të qëndrueshme. Andaj vlerësoj se ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

Konstatimi i shtatë (VII)- Argumenti rreth ndriçimit dhe çështjes së bodrumit është i qëndrueshëm bazuar edhe në kërkesën e dhënë me detyrë projektuese ku ceket që bodrumi duhet të ketë ndriçim natyral sa më shumë, tek pjesa e terrenit teknikisht është mundësia e mbushjes dhe rrafshimit që mundëson prezantimin sikurse projektuese me vlerën 8719 dhe nuk qëndron. Argumenti rreth mungesës së dimensioneve në planimetri është i qëndrueshëm, nuk figurojnë të jenë dhe ky fakt krijon vështirësi në krahasimin e parametrave dhënë nga detyra projektuese. Emërtimi i veprimtarive si Pediatri apo Dermatologji nuk duhet të konsiderohet shkelje sepse dhomat e tilla mund të emërohen si ordinancë. Të qëndrueshme janë edhe faktet për mungesë paradhome tek ordinacat, hapësira për dhënieve e infuzioneve. Argumenti që nuk ka pisuar tek Toaletet e meshkujve nuk qëndron sepse figurojnë të jenë në përputhje me kërkesat. Mungesa e hapësirave si: Barnatorja, Ordinanca e Vaksinimit, Gardëroba e personelit tek Labororët, Hapësira e punës për analiza laboratorike, Hapësira për administrim të laboratorit, Salla e hapur stomatologjike, të gjitha këto janë të sakta dhe të bazuara karshi kërkesave të detyrës projektuese dhe si të tilla duhet të merren parasysh. Poashtu prezantimi i situacionit ka mungesë të kufirit të parcellës e që i njëjti është shumë me rëndësi të prezantohet sepse vërehet organizimi i lëvizshmërisë, çasja, vendosja e planimetrisë etj. I njëjti argument është i qëndrueshëm. Si argumente pothuajse të gjitha janë të sakta sepse në projektin me shifrën 8719 ka mungesë të trajtimit të hapësirave, mungesë informatash të kërkuara nga AK, sipas kushteve të dhëna në Dosjen e Tenderit Aneksi 1, Par. VIII. Andaj vlerësoj se ky pretendim i ngritur është i bazuar.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues për ankesën Psh.nr. 621/23

Kantstaimi i parë (I)- Argumenti 1a: Sipas ekspertit teknik këto pretendime të ngritura janë të bazuara dhe të argumentuara pasi që nuk është respektuar distanca e objektit nga kufiri i parcelës min. 1h (h=lartësia bruto e objektit mbi parter) te Bazuar në Detyrën Projektuese të dhënë nga AK.**Argumenti 1b:**Sipas ekspertit teknik këto pretendime të ngritura janë të pabazuara sepse pozicionimi i objektit në parcelë ka mundësi zhvendosje për 0.73 m në diagonal, njëherit distanca deceditive prej 20.0 m' nuk figuron në kushtet e dhëna me Dosje të Tenderit sipas D.T.Art.VIII "Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Shërbimeve Urgjente në Shtime", par. Kushtet ndërtimore:"Distanca nga rruga ekzistuese duke iu referuar gjendjes faktike harmonizim me tërësinë ndërtimore në parcelë dhe rrethinë", poashtu është vetëm

supozim dhe jo argument. Andaj ky pretendim është i pabazuar. **Argumenti 1c:**Sipas ekspertit teknik këto pretendime rreth respektimit të vijës ndërtimore janë evidente por lehtësisht të përmirësueshme sepse ka hapësirë të distancimit të objektit. Tutje në FDT, Aneks 1. Sqarohet: Planifikimi i objektit duhet të bëhet duke marr parasysh qasjen vetëm nga rruga “Tahir Sinani” (Rruga: Shtime – Suharekë), andaj ky pretendim është i bazuar. **Argumenti 1d:**Në Detyrën Projektuese të dhënë nga AK, po ashtu në FDT, Aneks 1. Sqarohet Planifikimi i objektit duhet të bëhet duke marr parasysh qasjen vetëm nga rruga “Tahir Sinani” (Rruga: Shtime – Suharekë), ndërsa OE 3005 ka prezantuar çasje nga ana lider me qëllim të shfrytëzimit të hapësirës (për parkingje) në kundërshtim me kërkesën e dhënë. Në këtë mënyrë ka vështirësuar edhe çasjen për personel andaj ky pretendim është i bazuar.**Argumenti 1e:****Sipas ekspertit teknik këto pretendime të ngritura janë të bazuara dhe të argumentuara pasi që nuk është respektuar distanca e objektit nga kufiri i parcelës min. 1h (h=lartësia bruto e objektit mbi parter) të Bazuar në Detyrën Projektuese të dhënë nga AK.****Argumenti 1f:**Sipas ekspertit teknik këto pretendime të ngritura janë të bazuara dhe të argumentuara pasi që nuk është evidentuar në prezantim grafik kufiri i parcelës dhe njëherit distancat nga kufiri i parcelës gjë që e vë në pikëpyetje edhe pozicionimin e objektit në kuadër të tërësisë së parcelës.

Konstatimi i dytë (I)- Argumenti 2a: Pretendimet e ankuesit lidhur me projektin me shifër 8485 në përgjithësi janë të bazuara. Sqaruar në shumë raste pasi që niveli i projektit është në fazën konceptuale/ideore dhe ka mundësi modifikimi dhe përmirësimi të vërejtjeve pa e cenuar zgjedhjen arkitektonike.

Hapësira e triazhimit është ekzistuese dhe është e rrethuar me mure nga të gjitha anët përveç hyrjes e cila ka një pult pranimit në vend të të cilës mund lehtësisht të punohet muri dhe të konsiderohet dhomë, ky ndryshim mund të ipet vërejtje dhe i njëjti revidohet në fazën e projektit kryesor. Bazuar në kërkesa sipërfaqja e erëmbrojtësit është më e vogël nga ajo që është kërkuar por analizuar në aspektin teknik, mund të cilësohet si vërejtje dhe i njëjti të revidohet. Argumentet për nyjet sanitari karshi detyrës projektuese të dhënë nga AK janë të qëndrueshme, por duhet sqaruar se të gjitha këto vërejtje mund të përmirësohen në fazën e projektit kryesor.Pretendimi për numrin e madh të hyrjeve është i qëndrueshëm kur në FDT është cekur në mënyrë specifike numri dhe destinimi i secilës hyrje, andaj ky argument qëndron.**Argumenti 2b:**Eksperti teknik konsideron që të gjitha këto vërejtje të palës ankuese duhet të merren si të pabazuara sepse janë elemente të cilat mund të revidohen në fazën e projektit kryesor, analizuar projektin me shifrën A3P7 ka hapësirë të mjaftueshme për inkorporim pa e cenuar zgjidhjen funksionale apo arkitektonike të projektit.

Pretendimet e OE ankues janë të qëndrueshme sa i përket mungesës së dy ordinancave. Sa i përket Dhomes për IT është evidente si hapësirë dhe ndarja fizike mund të bëhet në fazën e Projektit Kryesor kur saktësohet hapësira e nevojshme për IT. Duke marr parasysh që është Dhomë për punëtor dhe mundësia e inkorporimit të një dush kabine është e mundshme, andaj edhe ky pretendim konsideroj që është i pabazë.**Argumenti 2c:**Mendimi i ekspertit teknik është se OE ankues ka të drejtë pjesërisht sa i përket argumenteve të dhëna për OE 0306, i cili nuk ka zbatuar argumentet e dhëna nga pala ankuese sipas kriterëve dhe kërkesave të cekura në FDT, Aneksi 1 Specifikimet Teknike dhe/ose Estetike të Detyrueshme, Par.VII.

Është sqaruar edhe në pretendimet e tjera që pritorja mund të organizohet edhe në kuadër të koridorit dhe nuk duhet konsideruar si shkelje e detyrës projektuese. Pretendimet rreth mungesës së një grupacioni të toaleteve janë të qëndrueshme sepse në prezantimin grafik figurojnë të jenë vetëm një grup i toaleteve për pacient në shërbim të Diagnostikës dhe Laboratorit. Pretendimet e

çështjes së arkivit janë të bazuara dhe evidente që nuk është respektuar kërkesa në përgjithësi karshi detyrës projektuese të sqaruara nga pala ankuese. Duke marr parasysh pozicionimin e përshtatshëm të kësaj hapësire në afërsi të grupacionit të laboratorit nuk konsideroj që duhet të merret për bazë si argument.

Argumenti 2d: Mendimi i ekspertit teknik është se OE ankues ka të drejtë në shumicën e argumenteve, sipas kriterëve dhe kërkesave të cekura në FDT, Aneksi 1 Specifikimet teknike dhe/ose estetike të detyrueshme, Par.VII. Mungesa e një pisuari mund të konsiderohet vërejtje e cila revidohet në fazën e projektit zbatues. Mungesa e garderobave është evidente andaj qëndron si argument. Njëjtë mungesa e nje pisuari mund të revidohet në fazën e projektit kryesor. Argumenti për mungesën e banjës në hapësirën e mirëmbajtjes tek dhoma e punëtorëve është i qëndrueshëm. Pozicioni i ashensorëve është i përshtatshëm sepse ka kontrolle nga recepcioni, çasje direkte nga hyrja etj. Ky pretendim është i pabazuar. Po ashtu edhe mungesa e hapësirave të jashtme është evidente dhe si argument është i bazuar. **Argumenti 2e:** Pretendimet e palës ankuese janë pothuajse të gjitha të paqëndrueshme. Duke marr parasysh nivelin e projektit Koncept-Ideor ku gjatë procesit ka hapësirë për revidim e sidomos kur ka të bëjë me pozicione të enterierit, andaj edhe ky pretendim duhet të konsiderohet i pabazuar. Mungesa e një pisuari nuk mund të konsiderohet shkelje, janë elemente sanitare dhe lehtësisht mund të inkorporohet në kuadër të nyjeve sanitare. Pritorja mund të organizohet edhe në kuadër të koridorit me ulëse dhe ky pretendim nuk duhet të merret për bazë. Është i qëndrueshëm fakti rreth mungesës së njërit toalet për femra dhe i paqëndrueshëm për pisoaret sepse janë evident në projekt. Ky pretendim nuk është i bazuar sepse nuk ndërlihet, së pari me sipërfaqen e hollit në projekt dhe çështja e pritores, teknikisht mund të organizohet në kuadër të koridorit. Qëndron si vërejtje mungesa e depos e një boksi me dy njësi, por teknikisht mund të inkorporohet në hapësirë pa problem dhe e njëjta mund të revidohet në fazën e projektit kryesor. Njëjtë pritortja mund të organizohet në kuadër të koridorit andaj nuk mund të merret si e bazuar.

Argumenti 2f: Mendimi i ekspertit teknik është se OE ankues ka të drejtë plotësisht sa i përket argumenteve të dhëna për OE 8719 i cili nuk ka zbatuar argumentet e dhëna nga pala ankuese sipas kriterëve dhe kërkesave të cekura në FDT, neksi 1 Specifikimet teknike dhe/ose estetike të detyrueshme, Par.VII.

Argumentet të listuara më poshtë janë të gjitha të qëndrueshme dhe të bazuara dhe është evidente mungesa e tyre: Hapësira për dhënie e infuzioneve është i paraparë të jetë te grupacioni i ordinancave por i njëjti mungon. Po ashtu barnatorja për shërbim të pacientëve dhe hapësira për vaksinim hyn në grupacionin e ordinancave dhe të njëjtat nuk janë evidente në projekt. Te pjesa e Laboratoreve: Mungesa e Garderobës, Hapësira e punës për analiza laboratorike me sipërfaqe prej 25.0 m² si dhe hapësira e punës administrative e këtij grupacioni, të gjitha argumentet janë të pabazuara dhe mungojnë në projektin e OE 8719. Të gjitha pretendimet për Hapësirën e mirëmbajtjes janë të qëndrueshme dhe të bazuara, të njëjtat nuk janë të prezantuara në projektin e OE 8719. Pretendimi që OE 8719 ka mungesë të informative dhe hapësirave në projekt është i qëndrueshëm, andaj ky pretendim në tërësi duhet të merret për bazë.

Konstatimi i tretë (III)-Sipas ekspertit teknik këto pretendime të ngritura janë subjektive edhe pse janë të qëndrueshme karshi ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për “Mbrojtje nga Zjarri”, e të cilat duhet që në fazën e Projektit kryesor të paraqiten me Elaborat të Mbrojtës nga zjarri, të përpiluara nga ekspertët e fushës përkatëse. Sipas Detyrës Projektuese nga konkurruesit është kërkuar që mbrojtja nga zjarri të merret për bazë. Andaj në këtë fazë të projektit ideor nuk konsideroj që është shkelje dhe ky argument merret i pabazë.

*Konstatimi i katërt (IV)-Argumenti 4a:*Sipas Ekspertit Teknik pretendimi i palës ankuese rreth OE tjerë qëndron pjesërisht sepse vërejtjet janë evidentuar dhe sqaruar, paraprakisht në argumentet e dhëna nga OE 1214. Sa i përket çështjes së poentimit dhe analizës së projektit, poentimi është bërë në përputhje me kriteret dhe nënkriteret nga juria profesionale.**Argumenti 4b:**Eksperti Teknik konsideron që pala ankuese ka të drejtë dhe argumenti duhet të merret për bazë.

Argumenti 4c: Sa i përket këtij pretendimi eksperti sqaron se nuk ka të dhëna për paramasë dhe parallogari gjë që e pamundëson vërtetimin e këtij pretendimi në krahasim me vlerësimin e jurisë profesionale. Si pretendim nuk mund të merret i bazuar.

Argumenti 4d: Eksperti Teknik konsideron që pala ankuese ka të drejtë dhe duhet të merret për bazë.**Argumenti 4e:** Eksperti Teknik sqaron që pretendimi i palës ankuese është subjektive dhe paragjykuese. Prezantimi i arkitekturës se qëndrueshme nga OE 1412 është shumë i varfër duke pasur parasysh gamën e gjerë të parametrave që hyjnë në këtë përkufizim. Më detajisht kulmi i gjelbërit nuk është aspak racional dhe i qëndrueshëm pasi që mirëmbajtja dhe investimi janë shumë të larta krahasuar me funksionin e sidomos në rastin kur nuk shfrytëzohet. Brisolet vertikale të prezantuara kanë distanca të mëdha dhe si të tilla ndikimi i insolimit të fasadës është minore e sidomos nëse mbulesa/hijezi horizontal nuk është prezent sikurse tek projekti 1412. Sasia e panelave solare konsideroj që është e vogël krahasuar me hapësirën e mundshme të shtrirjes së tyre. Në prezantim grafik nuk ka ndonjë detaj apo specifik ku mund të evidentohen materialet e reciklueshme. Andaj ky pretendim konsideroj që është i pabazuar.

Përmbledhje e konkluzionit të OE 1412:

“OE ankues pretendon se: “Komisioni për vlerësim profesional ka nxjerr rezultate diskriminuese me qëllim të eliminimit nga ky aktivitet i prokurimit si OE i përgjegjshëm dhe që i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Gjithashtu OE pretendon që projektet me shifrat 8485, A3P7, 0306, 3005, 1208 dhe 8719 bazuar në mosrespektimin e kërkesave të Detyrës Projektuese dhe Nenit 20.9 Specifikimet Teknike sipas RRUOP të këtij konkursi projektimi dhe rrjedhimisht edhe të rregullativës ligjore në fuqi, janë projekte të papërgjegjshme. Përfundimisht sa i përket mënyrës se vlerësimit OE pretendon se janë përdorur standard të dyfishta, duke mos bërë vlerësimin e drejtë të projekteve pjesëmarrëse në këtë konkurs projektimi, me diskriminim rrënjësor, dhe se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë në mënyrë objektive, profesionale dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.”

Pretendimet e ngritura nga pala ankuese janë kryesisht të bazuara nga raporti i Vlerësimit të jurisë profesionale nga AK, ku të njëjta janë analizuar më detajisht dhe janë përdorur si argumente. Gjatë argumenteve sipër disa herë është sqaruar niveli i projektit në këtë fazë konkurimi, ku shumë prej tyre janë të revidueshme në fazën e projektit kryesor. Pretendimi i aplikimit të standardit të dyfishtë është mendim i OE 1412, poentimi dhe vlerësimi mbetë në kompetencë të jurisë profesionale të caktuar nga AK, duke i respektuar kriteret e vlerësimit të përcaktuar nga vet AK. Ndërsa çështja e diskriminimit rrënjësor mendoj që është e ekzagjeruar sepse analizuar projektin e OE 1412, dhe vërejtjet e bëra nga komisioni është e identifikuar që nuk qëndron, fakti që ka respektuar dhe plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Andaj përfundimisht eksperti teknik konsideron që i vetmi pretendim i qëndrueshëm karshi ankesës është poentimi i ulët i OE 1412 e që ka ndikuar në rangim të ulët, duke u bazuar në krahasimin me kërkesat teknike të dhëna nga AK.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues për ankesën Psh.nr. 622/23

Konstatimi i parë (I)- Eksperti sqaron se në pretendimin e ngritur OE ankues nuk ka cekur fare se cilat kritere specifike nuk janë përmbushur nga ana e AK dhe poashtu nuk është paraqitur asnjë arsye se pse poentimi është me më shumë pikë përderisa është e qartë metoda e poentimit të dhënë në Dosjen e Tenderit Aneksi 1, Par. IV. Andaj vlerësojmë se ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

Konstatimi i parë (I)- Sipas ekspertit teknik këto pretendime të ngritura janë shumë të paqarta dhe subjektive. Nuk ka argumente specifike dhe për këtë pretendim nuk është cekur se për cilat kthina dhe sipërfaqe përkatëse është fjala se nuk janë plotësuar, andaj konsideroj që ky pretendim është i pabazuar.

Konstatimi i dytë (II)- Mendimi i ekspertit teknik është se OE ankues nuk e ka saktësuar se për cilin standard të sigurisë në objekt i është referuar. Kjo nuk është kërkesë e parashtruar në detyrën projektuese, dhe mendoj që si fazë duhet të trajtohet në Projektin Zbatues (Siç është: Elaborati i Mbrojtjes nga Zjarri apo Siguria në Punë etj.). Çështja e trajtimit të personave me aftësi të kufizuara të lëvizjes bazuar në prezantimin grafik të konkurrenteve apo OE me shifrat: 8485 dhe A3P7, qasja në hyrjen e objektit është në nivelin e njëjtë me parterin dhe po ashtu ka rampa nga niveli i parkingjeve tek hyrja kryesore. Sa i përket enterierit dhe skemës funksionale e tërë sipërfaqja shtrihet në të njëjtin nivel gjë që nuk ka probleme lëvizjeje si dhe toaletet janë të parapara konform nevojës së paraqitur në detyrë projektuese.

Konstatimi i tretë (III)- Eksperti teknik sqaron se konkursi i projektimit është një proces i rëndësishëm dhe i hapur që ndihmon në zgjedhjen më të qëndrueshme karshi kërkesave të dhëna në detyrë projektuese. Si bazë duhet të merret parasysh edhe niveli i projektit sidomos në Arkitekturë i cili dallon ai Ideor/Konceptual me atë Zbatues/Kryesor me faktin se ka çdo herë hapësirë dhe mundësi për revidime të cilat nuk e cenojnë asnjë aspekt të projektit. Pretendimet e palës së dëmtuar nuk bazohen në asnjë standard konkret, të gjitha komentet janë subjektive dhe nuk i referohen kushteve përkatëse teknike të dhëna në detyrën dhe pikat e saj. Pala ankuese nuk ka dhënë prova të mjaftueshme për pretendimet e tyre. Nuk është paraqitur njësia krahasuese për vlerësimet e dhëna si: Aspekti funksional, efienca e energjisë, siguria, standardet përkatëse. Ndërkaq krahasimet rreth poentimeve dhe analizave të cilat janë bërë nga ekipa profesionale në përputhje me nenin 80 të LPP-së janë të njëanshme dhe nuk qëndrojnë, sepse vet vlerësimi në total është bërë detajisht dhe është poentuar për secilin aspekt të parapara me Dosje të Tenderit. Duke u bazuar në atë se çfarë u sqarua më lartë vlerësoj se pretendimet e ngritura në ankesë janë të pabazuara.

-Konstatimet e panelit shqyrtues-

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e

tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore.

Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj paneli mbështet shpjegimet dhe arsyetimet e dy ekspertëve shqyrtues teknik dhe profesional që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim vlerësimin.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e dy ekspertëve shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komeriale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - ARHIKO .JNG SH.P.K., N.N.SH. " Vizion Project ", ARCH EMPIRE L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: